



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT
MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/107;
Datë: 23.09.2016 .

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA		
Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-04-7541	2	23.09.2016

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2. pika d); nenit 14 paragrafi 2. pikat a), b), c) dhe e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 7 paragrafi 3. të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Ligji Nr. 04/L-144, GZRK numër 35/17); dhe nenit 19 paragrafi 2. të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 23.09.2016 nxjerrë:

V E N D I M P A R A P R A K

për

Dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale

I. Me këtë vendim miratohet vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale.

II. Me këtë vendim lejohet shprehja e interesit në pronën e paluajtshme të komunës në Parcelat kadastrale numër **1563-2** dhe **1564-2** në sipërfaqe të përgjithshme prej **4732 m²** në vendin e quajtur Pepsh-Varrezat e Gacaferit, kultura - tokë bujqësore, shfrytëzimi aktual - kullosë.

III. Parcelat kadastrale nga pika II. e këtij vendimi janë pronë komunale dhe evidentohen në Certifikatat e pronësisë numër P-73105038-01563-2 dhe P-73105038-01564-2.

IV. Sipërfaqja nga pika II. e këtij vendimi jepet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 (nëntëdhjetenëntë) vitesh përmes konkursit të hapur publik sipas kriterëve të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

V. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nga pika II. e këtij vendimi është zhvillimi i veprimtarisë afariste përmes fabrikës së përpunimit të frutave.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut, Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Komisioni për Ankesa.

VII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushojnë së vlejti të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

IX. Arsyetim:

Lejimi për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë sipas këtij vendim është me interes publik vital për zhvillimin e komunës së Junikut, respektivisht plotësimin e nevojave të veprimtarive afariste me çka do të krijoheshin kushte për punësim dhe zhvillim ekonomik të komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës;
4. Komisioni për Ankesa;
5. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
6. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://rks-gov.net/junik>